



Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme 2017

Me date 7 Dhjetor 2017 u mblodh asambleja e pergjithshme e zakonshme.

Mbeshtetur ne statutin e FSHA-se ku krahas asamblese zgjedhore zhvillohet dhe asambleja e zakonshme vjetore.

Rendi i dites se asamblese perbehej nga keto pika:

1. Verifikimi i perberjes se mbledhjes.
2. Raporti i Presidentit.
3. Miratimi i raportit te aktiviteve te K.E-se.
4. Miratimi i raportit financiar.
5. Miratimi i veprimtarive financiare per vitin pasardhes.
6. Zgjedhjet per cdo vend vakant.
7. Shqyrtimi i propozimeve per amendamentet ne statutin e FSHA-se.
8. Diskutime nga anetaret per ceshtje te tjera.

Presidenti z. Gjergj Ruli paraqiti raportin e tij,ku vleresoi per punen e tyre trajneret,klubet dhe sportistet per vitin 2017.

Gjithashtu Sekretari i FSHA-se z. Nikolin Dionisi paraqiti raportin teknik te aktiviteve te zhvilluara gjate vitit,ku u shoqerua me pas edhe me raportin financiar nga shefi i finances z. Igli Binjaku.

I pranishem ishte dhe z. Arjan Konomi Drejtor i Politikave dhe Strategjive te Zhvillimit te Arsimit,Sportit dhe Rinise, perfaqesues i Ministrise se Arsimit dhe Sportit i cili prezantoi dhe ligjin e ri te sportit si dhe disa orientime te MASR per federatat,klubet dhe shoqatat per vitin 2018 edhe ne vazhdim.

Ne kete asamble u aprovua dhe projekt kalendari dhe projekt buxheti per vitin 2018 ku do te jete MASR qe do te vendosi shumen per fondin GRAND per vitin 2018.



